

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 570 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 38, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Durrësi në Antikitetin e Vonë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Brikena Shkodra Rrugia (IA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Durrësi në Antikitetin e Vonë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Brikena Shkodra Rrugia (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Verifikimi i mbetjeve strukturore.
 - Dokumentimi i të dhënave të reja stratigrafike dhe identifikimit të fazave kronologjike.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë data 1-20 qershor 2016
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al